



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 30/18
Prishtinë, më 25.07.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi, Fikrim Damka dhe Enver Hoti.

Munguan: Ali Lajçi, Naser Osmani dhe Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Valdete Daka – Kryetare e KQZ-së, Enis Halimi - Kryeshef i Sekretariatit të KQZ-së, Miradije Meha nga KQZ, Dritan Gjonbalaj – Drejtor i Përgjithshëm në AAC, Xhelil Bekteshi nga AAC, Hysa Matoshi nga AAC, Shqipe Selishta nga AAC, Shkumbin Hyseni – Anëtar i Bordit të ARH-së, Shkelzen Qorri nga ARH, Fehmi Mehmeti – Guvernator i BQK-së (tutje Guvernatori), Lulzim Ismajli – Zëvendësgruvernator i BQK-së, Emine Fazliu dhe Faruk Nura nga ZKA.

Pjesëmarrës tjerë: Besjana Bajrami – Gazetare, Albulena Mavraj – Gzetare, Rrahman Ramaj – Gazetare, Emine Shehu – praktikante në Kuvend, Egzon Dobroshi nga KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Propozojë që të bëhet një ndryshim i pikave të rendit të ditës, pika e 2 të kalojë si pika e 6 e rendit të ditës.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi rendin e ditës, me një rirenditje, ku pika e 2 zhvendoset si pika e 6 e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (tutje KQZ) për vitin 2017

Kryetari: Ja kalojë fjalën përfaqësuesve të KQZ-së për të paraqitura raportin financiar për vitin 2017.

Valdete Daka: Theksoi se KQZ vitin e kaluar ka organizuar dy parë zgjedhje: qendrore dhe lokale. Buxheti për vitin 2017 ka qenë 11,618,324 euro, sipas kategorive: paga dhe mëditje 707,864 euro, mallra dhe shërbime 6,436,269 euro, shpenzime komunale 48,390 euro, subvencione dhe transfere 4,200,000 euro (fondi i dekomkratizimit për partitë parlamentare) dhe shpenzimet kapitale 225,800 euro. KQZ për zgjedhjet e parakoshme nuk ka pasur buxhet të planifikuar dhe sipas kërkesës. Qeveria i ka ndarë KQZ-së buxhet shtesë prej 3 milion euro. Me rishikim të buxhetit është ndarë buxhet për zgjedhjet lokale në shumë prej 1,944,900 euro, të cilat janë alokuar në programin e zgjedhjeve, në mallra dhe shërbime. Me Vendim të Qeverisë dhe kërkesë të Ministrisë së Financave, është kursyer buxheti nga dy projekte kapitale në vlerë prej 81,000 euro dhe i është kthyer buxhetit të Kosovës. Përfshirë këto ndryshime, si përfundim buxheti i KQZ-së ka qenë 16,482,224 euro. Buxheti i shpenzuar 16,602,782 euro apo 94.4%, prej të cilave paga dhe mëditje 1,260,967 euro apo 99.6%, mallra dhe shërbime 10,689,403 euro 96.8%, shpenzime komunale 34,900 euro apo 49.8%, subvencione dhe transfere 4,196,859 euro apo 99.9% dhe shpenzimet kapitale 114,652 euro 79.1%.

Shpenzimet e zgjedhjeve qendrore janë në shumë prej 4,380,768 euro dhe një kosto prej 2.2 euro për një votues. Ndërkaq, shpenzimet për zgjedhjet lokale, përfshirë raundin e dytë dhe për rivotim në Komunën e Istogut ishin në shumë prej 7,180,824 euro dhe kishin një kosto për një votues 3.71 euro. Pra, për zgjedhjet e mbajtura në vitin 2017, gjithsej janë shpenzuar 11,570,591 euro.

Kryetari: Ja kalojë fjalën përfaqësuesve të ZKA-së, për të paraqitur raportin e auditimit për KQZ-në.

Emine Fazliu: ZKA ka publikuar raportin për pasqyrat financiare të KQZ-së për vitin 2017 dhe opinionin është i pakualifikuar me theksim të çështjes. Arsyja e theksimit të çështjes ka të bëjë me furnizimet për material zgjedhor në vlerë prej 130,175 euro që ishte përtej vlerës dhe sasisë së kontraktuar, dhe kjo me rastin e organizimit të zgjedhjeve lokale. Përveç prezantimit të çështjes janë identifikuar edhe disa gabime në prezantimin e të dhënave financiare, si depozitat nuk ishin prezantuar saktë si dhe pasuritë dhe llogaritë e arktueshme ishin nënvlerësuar si rezultat i mosregjistrimit dhe mosshpalosjes. Vlenë të theksohet se KQZ ka shënuar një progres në menaxhimin dhe qeverisjen e organizatës. Menaxhmenti i KQZ-së është pajtuar me përbajtjen e raportit dhe është zotuar në implementimin e rekomandimeve të auditimit.

Kryetari: Njëri prej rekomandimeve të ZKA-së është që KQZ-të të implementojë rekomandimet e vitit paraprak. Cilat janë këto rekomandime nga viti paraprak që nuk janë implementuar?

Emine Fazliu: Në vitin 2016 janë bërë 13 rekomandime. Prej tyre 8 janë zbatuar plotësisht, 3 janë në proces dhe 2 nuk janë zbatuar. Rekomandimet e pazbatuara, kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive, ndërsa ato në proces kanë të bëjnë me menaxhimin e personelit dhe të rreziqeve.

Enis Halimi: Çështjet që u ngriten nga auditorët ka të bëjë me sistemin e regjistrimit të e-pasurisë, e që kemi problem edhe për shkak të mosfunksionimit të sistemit që lidhet me Ministrinë e Adimistratës Publike. Sa i përket menaxhimit të rrezikut, e kemi hartuar strategjinë e menaxhimit të rrezikut. Është evidente se ka pasur tejkalime në disa kontrata të furnizimit me material zgjedhor dhe ne kemi mbetur borq, pasi që kemi dashur të sqarojmë se çfarë ka ndodhur me këto furnizime, si rezultatës i kontratës në mes menaxherit të kontratës dhe furnitorit. Vlera e tepricës për disa kontrata me tejkalime për këto furnizimeve të materialit zgjedhor në total është 137,000 euro.

Blerim Kuçi: A keni bërë planin e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2017. Cilat janë format e procedurave të prokurimit që keni aplikuar për materialet që furnizohen. Tejkalimet për furnizimin e materialeve, a kanë të bëjnë me zgjedhjet nacionale apo lokale?

Arbërie Nagavci: Kërkojë sqarime për rekomandimin e auditorit që ka të bëjë me menaxhimin e personelit, konkretisht për avansimin e pozitive menaxheriale pa procedura?

Mërgim Lushtaku: Tek çështja e tejkalimit të shpenzimeve për furnizime me material zgjedhor, më intereson të dijë, se për çfarë material është fjala?

Kryetari: kërkojë një sqarim për përdorimin i shpeshtë të procedurës së pa publikuar, pse është përdorur kjo procedurë edhe për zgjedhjet e rregullta?

Enis Halimi: Sqaroi se KQZ ka hartuar planin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Lidhur me procedurat e prokurimit, varësisht nga lloji i zgjedhjeve i aplikojmë ato. Ne kemi filluar me procedura të hapura, në ndërkohë janë shpallur zgjedhjet parlamentare, për shkak të zvarritjes së procedurave dhe me qëllim të menaxhimit të procesit jemi detyruar të aplikojmë procedurat e tilla të prokurimit. Menaxhimi i personelit dhe avansimi në pozita menaxheriale, ne kemi pritur miratimin e rregulloreve të reja dhe si rezultat i kësaj janë bërë këto rregullime të pozitive sepse nuk kemi pasur mundësi zgjidhjeve tjera.

Emine Fazliu: Sqaroi se për çështjen që iu kemi referuar në rekomandime është tenderi për furnizim me sprej për zgjedhjet lokale 2017 në vlerë prej 44,400 euro.

Blerim Kuçi: A ka mundësi që të rregullohet procesi, apo miratimi i një rregullore të posaçme në konsultim edhe me KRPP, që të dihet forma e prokurimit të blerjes së materialeve zgjedhore edhe për zgjedhjet e parakoshme dhe jo me bë kërkesë sipas rastit.

Valdet Daka: Theksojë se në mungesë të bazës ligjore, për zgjedhjet e parakoshme jemi obliguar të aplikojmë procedurat e negociuara. Ligji i prokurimit nuk e parasheh procedura të veçanta për zgjedhjet. Pse ka ndodhur për zgjedhjet lokale është si pasojë se OSHP ka prishur vendimet dhe për shkak të kohës kemi shkuar me procedura të negociuara.

Enver Hoti: Çfarë është duke ndodhur me listat e votuesve, pasi që kjo ndërlidhet edhe me furnizimet për material zgjedhor, për të cilën u diskutua dhe auditori e ka evidentuar se ka pasur tejalim të shpenzimeve?

Kryetari: Duke u ndërlidhur me parafolësin, pyeti a porositen fletëvotime sa është numri i votuesve apo porositen sa normalisht sa parashikojmë që kanë me dal?

Valdet Daka: Sqaroi se porositen më shumë fletëvotime se sa ka votues dhe këtë e thotë edhe Ligji për zgjedhjet. Ndërsa, për dy parë zgjedhjet e fundit, porosisim 10% më pak se sa ka votues, për shkak të të faktit se asnjëherë nuk kemi pasur më shumë votues se 800,000, në cilado çoftë zgjedhje.

Kryetari: Sa është kostoja e materiale të djegura, pas zgjedhjeve?

Enis Halimi: Sqaroi se implikimet financiare, ka të bëjnë vetëm me numrin më të madhë të fletëvotimeve.

Enver Hoti: Theksojë se është e nevojshme të kemi një listë për mëditjet e udhëtimeve jashtë vendit. Përderisa ekziston një listë e tillë për Kuvendin, pse mos të jetë edhe për institucionet tjera.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve për vitin 2017.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (tutje AAC) për vitin 2017

Kryetari: Ja kalojë fjalën përfaqësuesve të AAC-së për të paraqitura raportin financiar për vitin 2017.

Dritan Gjonbalaj: Theksoi se nga buxheti i përgjithshëm nga 869,609 euro, AAC ka realizuar buxhetin në përqindje prej 96%. Të hyrat kanë qenë 1,865,604 euro. Kemi pasur kursime në shpenzimet komunale, në karburante dhe shpenzime të përfaqësimit. Sa i përket shpenzimeve jashtë vendit, 81% e buxheti është shpenzuar për trajnimet e stafit, ndërsa 19% janë shpenzime për përfaqësimin e Kosovës në ngjarjet lidhur me punën e AAC-së. Në shpenzimet për karburant, mesatarja ka qenë 50 euro në muaj për veturë. Shpenzimet në telefoni fikse, mesatarja ka qenë 2.6 euro për person. Ndërsa, shpenzimet e reprezentacionit ka qenë 838 euro nga 3,000 të planifikuara.

Plani i prokurimit nuk ka mundur të realizohet në tërësi, siç është planifikuar, pasi që prokurimi për AAC dhe disa agjenci tjera, kryhet nga AQP, dhe për shkak të ngarkesës që ka pasur kjo Agjenci, nuk ka mundur të realizohet plani i prokurimit. Një shqetësim që e kemi që disa vite, është përkundër faktit që AAC gjeneron të ardhura të dedikuara, në tabelat e buxhetit figuron se AAC financohet nga grantet qeveritare. Lidhur me pagesën e Bordit Mbikëqyrës sipas vendimit të qeverisë, kemi kërkuar që të paguhet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve dhe jo nga mallrat dhe shërbimet. pasi që kjo po ndikon në ndarjen e buxhetit në kategoritë tjera. AAC është audituar nga ZKA dhe auditimi ka nxjerrur vetëm një rekomandim të natyrës teknike.

Emine Fazliu: Raporti i auditimit për AAC-në ka rezultuar me opinion të pamodifikuar. Ne kemi dhënë vetëm një rekomandim, që ndërlihet me disa gabime në prezantimin e informatave financiare që ka të bëjnë me atë se kemi një nënvlerësim të buxhetit final për 18,564 euro, si dhe nuk është shpalosur fondi i donatorëve në vlerë prej 4,694 euro. Në raportin e vitit 2016, ZKA ka dhënë 4 rekomandime, të cilat AAC i ka implementuar të gjitha.

Kryetari: Ju lutem të na konfirmoni sa a është paga mesatare në AAC prej 2,000 euro?

Dritan Gjonbalaj: Kofirmojë se paga mesatare në AAC është 2,000 euro.

Kryetari: Theksoi se duke pasur parasysh raportin e auditorit për këtë Agjenci, atëherë mund të marrin si shmebull pozitivë kur pagat kanë korrelacion me performancën financiare të institucionit. Sa i përket Bordit Mbikëqyrës, pyeti a marrin shitesa, jashta pagave?

Dritan Gjonbalaj: Sqaroi se niveli i pagave të AAC-së është paraparë me një nen të veçantë të Ligjit për Aviacionin Civil, i cili jep diskrecion Ministrisë të Financave në bashkëpunim me Drejtorin e AAC-së, të përcaktohen pagat. Bordi ka kompensim fiks të përcaktuar nga Qeveria dhe nuk merr asnjë kompensim tjetër.

Enver Hoti: Pyeti lidhur me projektin e zgjerimit të pistës së Aeroportit “Adem Jashari”, pasi që ka një mjegull në realizimin e tij? Po ashtu u interesua lidhur me çështjen e çmimeve të larta të biletave të udhëtimit?

Dritan Gjonbalaj: Sqaroi se tek dy pyetjet që u ngriten nga zoti Hoti janë jashtë fushëveprimit të AAC-së. Sidoçoftë nga ajo që dijë dhe komunikimi me zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës (MI) do të jap disa informata por që nuk janë zyrtare, për shkak të moskompetencës si agjenci për këto çështje. Biletat ende vazhdojnë të jenë të larta, përkundër që kërkesa është e lartë. Megjithatë Aeroporti i Prishtinës ka disa programe lehtësuese për kompanitë fluturuese që të nxiten të shtojnë numrin e fluturimeve, destinacioneve të fluturimit dhe të joshen kompanitë e reja. Si rezultat i këtyre programe kemi edhe kompani ajrore me çmime më të ulta. Biletat janë çështje e rregullimit ekonomik të transportit ajror brenda MI, por as ministria nuk ka hapësirë të gjërë veprimi, përveç kur vërehet abuzimi i pozitës dominuese në treg dhe këto çështje ti adresojë në Agjencinë e Konkurrencës. Zgjatja e Pistës së Aeroportit përfshinë edhe një projekt tjetër që është ngritja e sistemit instrumental të aterimit, përditësimi i tij që të mundësohen aterimet edhe në mjegull të tendur. Nga ajo që dijmë dhe inputet teknike që kemi dhënë si AAC, është nënshkruar marrëveshja në mes Qeverisë së Kosovës dhe Limak, për zgjatjen e pistës. Se ku qendrohet me implementimin e këtij projekti nuk kam përgjigje kompetente për t’iu dhënë.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2017.

4. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017

Kryetari: Ja kalojë fjalën përfaqësuesve të ARH-së për të paraqitura raportin financiar për vitin 2017.

Shkumbin Hyseni: Theksoi se buxheti është realizuar rreth 90% e planifikimit. ZKA ka dhënë një opinion më pozitivë se vitet paraprake.

Emine Fazliu: ZAK ka dhënë një opinion të pamodifikuar për ARH-në. Është identifikuar vetëm një gabim tek neni 19 se stoqet ishin të mbivlerësuar në vlerë prej 5,000 euro. ARH, bë vitin 2017 për herë të parë ka filluar të inkasojë të hyra dhe ato ishin në vlerë prej 2,450 euro. Ne kemi dhënë pesë rekomandime dhe menaxhmenti i ARH-së është pajtuar me përmbajtjen e raportit.

Fikrim Damka: A mund të jenë njëkohësisht një i punësuar të jetë edhe menaxher edhe anëtar i Bordit?

Kryetari: Pyeti nëse anëtarët e Bordit a marrin shtesa tjera, përveç pagës?

Shkumbin Hyseni: Sqaroi se në bazë të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, Kryeshefi ekzekutivë sipas deyrtrës zyrtare është edhe anëtar i Bordit. Ndërsa, anëtarët e Bordit, përveç kompensimit, nuk marrin shtesa tjera.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimit, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017.

5. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare

Kryetari: Ja kalojë fjalën zv. Kryetares së Komisionit dhe Raportueses së Grupit Punues, znj. Hadërgjonaj, për prezantimin e Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

Safete Hadërgjonaj: Siç jemi mandatuar nga Komisioni si Grup Punues, kemi hartuar planin e punës për mbikëqyrjes, në bazë të së cilit kemi mbajtur takime me institucionet përkatëse për të marrë të gjitha informatat se sa po zbatohet ligji dhe sa është pengesë ligji në kryerjen e detyrave të përcaktuara dhe për nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e tij. Jemi takuar me Ministrinë e Financave si sponzorizuese e ligjit, me BQK, Asociacionin e IMF, Shoqatën e Bankave, MAP, MTI dhe me Njësinë e Intelegjencës Financiare. Në bazë të vizitave dhe takimeve, ne kemi mësuar se ky Ligj, përgjithësisht është i zbatueshëm. Megjithatë, në bazë të vërejtjeve të ngritura nga institucionet e vizituara, kemi vërejtur se ka nevojë për disa përmirësime dhe ndryshime të ligjit, dhe si rezultat ato i kemi prezantuar si rekomandime në raportin e hartuar. Vlenë të theksohet se të gjitha institucionet e vizituara na i'u janë përgjigjur edhe në formë të shkruar në pyetjet që i'u kemi adresuar. Në gjithë këtë punë falenderojë shumë stafin mbështetës që kanë qenë korrekt dhe i kanë kryer detyrat dhe përgjegjësitë që i kanë.

Kryetari: Lidhur me rekomandimin e tretë, ku i rekomandohet Departamentit të OJQ në MAP që të revokohet statuti i përfituesit publik, ndaj Institucioneve Mikrofinanciare OJQ që nuk përdorin fitimin për përfitime publike apo për qëllimet për çfarë është themeluar, pyeti a keni vërejtur raste të tilla të funksionimit të IMF OJQ ekzistuese që nuk përdorin kapitalin për qëllime publike?

Safete Hadërgjonaj: Sqaroi se në takimin e zhvilluar në MAP, në bazë të diskutimeve ka pasur një rast i'u është revokuar licenca një IMF-OJQ dhe ne kemi dhënë rekomandim që të gjitha këto institucione që nuk veprojnë në përputhje me ligji, të mos iu lejohet vazhdimi i aktivitetit të tyre.

Mërgim Lushtaku: E falenderojë grupin punues për raportin e mirë, por do të ishte mirë të organizohej edhe një takim apo një dëgjim publik me institucionet mikrofinanciare, pasi që kemi marrë edhe komentet e tyre lidhur me Projektligjin për Institucionet Mikrofinanciare, dhe është në interes që të kemi

një harmonizim me ligjin në fuqi, kur dihet edhe fakti se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e shfuqizon Kreun II, që ka të bëjë me rregullimin e fushëveprimit të këtyre institucioneve mikrofinanciare.

Safete Hadërgjonaj: Sqaroi se Grupi Punues ka zhvilluar takim me Asociacionin e Institucioneve Mikrofinanciare dhe ai takim dhe diskutimet e zhvilluara janë pjesë e raportit. Sa i përket neneve të ligjit bazik që i ka shfuqizuar Gjykata Kushtetuese, ne nuk jemi marrë me atë pjesë. E kemi Projektligjin për Institucionet Mikrofinanciare në shqyrtim në komision dhe kemi mundësinë dhe duhet të rregullojmë fushëveprimin e këtyre institucioneve.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimit, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni miratoi Raportin me rekomandime të Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, dhe i njëjti procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2017

Kryetari: Ja kalojë fjalën Guvernatorit për të paraqitura Raportin të BQK-së për vitin 2017.

Guvernatori: Raporti është përgaditur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Bankën Qendrore dhe është miratuar nga Bordi i BQK-së. Përformanca e mirë ekonomike në eurozonë, ka pasur efekt pozitivë edhe në zhvillimin ekonomik të vendeve të rajonit. Raporti përmban të dhëna për ekonominë e Kosovës, ku gjatë vitit 2017 ka vazhduar të ketë rritje dhe sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave, norma reale ekonomike ishte 3.7%. Kjo rritje është gjeneruar nga rritja e investimeve prej 10.7%, ndërsa konsumi ka shënuar rënie prej 1.6%. Mbështetja e lartë nga importi i mallrave nga jashtë prej 9.2% dhe niveli i ultë të eksportit 22.1 prej vazhdojnë të jenë ndër sfidat kryesore të vendit. Si rezultat deficiti tregtar vazhdon të jetë i lartë 2.7 miliard euro apo 41.5% e GDP-së. Deficiti i lartë tregtar i mallrave vazhdon të jetë kontribuesi kryesorë në deficitin e llogarinë rrjedhëse dhe kapitale që arriti 425.1 milion euro apo 6.6% e GDP-së. Remitenat arriten vlerën 759.2 milion euro apo shënuan rritje prej 9.9%. Investimet e Huaja Direkte (IHD) arriten vlerën 287.8 milion euro. Struktura e IHD, vazhdon të dominohet nga sektori i patundshmërisë prej 65% e totalit të tyre.

Republika e Kosovës vazhdon të karakterizohet me nivel të ulët të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Zhvillimi i tregut të letrave me vlerë ka mundësuar për të hyra për qeverinë e Kosovës përmes instrumentit të borxhit dhe njëkohësisht ka mundësuar investimet në tregun e brendshëm financiar përmes blerjes së tyre.

Sistemi financiar po vazhdon të rritet me një ritëm të qëndrueshëm si rezultat i përmirësimit të kushteve dhe rritjes së kërkesës për kredi. Vlera e gjithsej kredive arriti 2.5 miliard euro apo rritje prej 11.5%. Rritje e kredive për sektorin e tregtisë 26.2%, bujqësisë 13.4% dhe prodhimit 9.3%. Strukutra e kredive mbetet e ngjashme si vitet e kaluara e dominuar nga ndërmarrjet e mëdha. Zvogëlimi i normave të interesit në kredi në mesatare prej 6.8% paraqet një lehtësim për qasje në financa. Roli të rëndësishëm po luan edhe Fondi për Garantimin Kreditor që kalojë shumën prej 30 milion euro. Zvogëlimi i kostos së kreditimit është ndikuar edhe nga normat e interesit në depozita që shënoi 1.3%. Burimi kryesorë i financimit në sektorin financiar vazhdojnë të mbetet depozitat e mbledhura brenda vendit që kanë shënuar 3.1 miliard euro apo rritje vjetore prej 6.8%. Norma e kredive jopërformuese shënojë 3.1%, krahasuar me 4.9% sa ishte një vit më herët. Treguesi i likuiditetit të bankave vazhdon të qendrojë rreth 37.9%. Po ashtu sektori bankar vazhdon të jetë i mirëkapitalizuar me tregues e mjaftueshmësië kapitale

me normë prej 18.1%. Performancë të kënaqshme shënuar edhe sektorët tjerë të sistemit financiar. Sistemi pensional shënoi rritje dhe vlera e përgjithshme e aseteve arriti 1.65 miliard euro apo 16% rritje. Sa i përket sektorit të sigurimeve, vlera e primeve shënoi një rritje 3.9%, përderisa dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve knaë shënuar rritje vjetore prej 17.8%. Sektori i sigurimeve shënoi për herë të parë performancë pozitive. Vlera e kredive në sektorin mikrofinanciar dhe financiar jobankar arriti 143.9 milion euro apo 34.2% rritje vjetore. Norma mesatare e interesit për sektor është 22.6%.

Parashikimet ekonomike të BQK-së për vitin 2018, parashohin një rritje ekonomike prej 4.2 – 4.4 %, ku bartësit kryesorë do të jenë investimet publike dhe private. Sa i përket aktiviteteve të BQK-së, në cilësinë e rregullatorit financiar, ka bërë avansimin e legjislacionit sekondar dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së, standardeve ndërkombëtare dhe Kornizën e Basel-it dhe të Siguruesve. Në këtë aspekt është bërë rishikimi i rregullave dhe procedurave të licencimit për të gjitha institucionet financiare. BQK ka vazhduar mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve financiare për të siguruar operimin e tyre në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. BQK ka vazhduar në përfaqësimin në organizatat ndërkombëtare dhe bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare financiare.

Kryetari: Kam lexuar raportin dhe janë disa observime për vitin 2017 e që lidhen edhe për punën tonë si Komision. Njëri prej observimeve ka të bëjë me kreditimin dhe diferencën e normës në mes institucioneve bankare dhe institucioneve mikrofinanciare. Përderisa bankat japin 2.5 miliard euro kredi me normë interesi 6.8%, institucionet mikrofinanciare japin kredi rreth 143 milion euro me normë interesi prej 22.6%. Përkundër normave të larta të interesit të kredive të institucioneve mikrofinanciare, kthimi i kredisë është i mirë. Më intereson të dijë politikën e BQK-së në këtë drejtim për të reduktuar këto norma të larta të interesit, që i marrin qytetarët e varfër që nuk mund të marrin kredi në banka dhe trajtohen si fajdexhi. Çfarë shërbimi po i bëjnë këto institucione mikrofinanciare shtetit me norma kaq të larta të interesit? A kemi nevojë për këto institucione? A kemi mekanizma ti reduktojmë këto norma? Në anën tjetër, kthimi i kredive në sektorin bankar është mjaftë stabil, gjë që tregojnë edhe niveli i kredive joperformuese. Ndërkaq, qasja në kredi është më e vështirë. Prandaj, në këtë drejtim do të krijohen lehtësime për qasje në kredi.

Ritja ekonomike prej 3.7% është jo e mjaftueshme për zhvillimin ekonomik, me këto norma Kosovës do ti duhen 32 vite me rritë Kroacinë. Si BQK, sa pritni që të jetë rritja ekonomike dhe niveli i investimeve në vitin 2018? Çfarë mund të bëjë BQK për krijimin e kushteve dhe lehtësirave për investime edhe në industrinë që janë të tregueshme dhe që mundemi me i ekspertu dhe që do të ndikonte në uljen e deficitit të lartë tregtar.

Lidhur me Rezolutën e Kuvendit është kërkuar që Byroja Kosovare të bëjë vlerësimin e polisave kufitare, a ka kthyer raport Byroja, a ka hapësirë që këto polisa të zvogëlohen, deri në gjetjen e një zgjidhje tjetër?

Gubernatori: Sa i përket normave të interesit të institucioneve mikrofinanciare, të gjitha institucionet financiare në bazë të Kushtetutës veprojnë në bazë të tregut të lirë dhe të hapur. BQK ka ngritur çështjen e normave të larta, por bazuar në kornizën rregullative ligjore nuk mundet të ndikojë në këtë çështje. Në bazë të analizave tona pse janë kaq të larta këto norma të interesit është se këto institucione nuk kanë kapital të vetin dhe kryesisht marrin kredi nga jashtë dhe kostoja e këtyre kredive është shumë e lartë dhe si rezultat japin kredi me norma më të larta. Sa a janë të nevojshme këto institucione, vetë fakti se kemi rritje të kredimit nga këto institucione prej 34.2%, ky sektor është target kryesisht për ekonomitë familjare, ndërsa bankat kanë target më shumë bizneset e mesme dhe të mëdha. Ajo qfarë mund të bëjmë si BQK, është të krijojmë kushte për regjistrimin e institucioneve të reja, që do të ndikojnë në rritjen e konkurrencës dhe si rrjedhojë në uljen e normave të interesit. Në kuadër të kësaj kemi pasur kontakte me disa banka të huaja që të operojnë në Kosovë, dhe për fokus i kemi nxitur të kreditojnë të bizneset e vogla dhe ekonomitë familjare dhe kjo do të ndikonte në konkurrencën me këto institucione mikrofinanciare dhe në uljen e normave të interesit.

Parashikimet ekonomike për vitin e ardhshëm nga BQK, janë 4.2-4.4%. Sa i përket Rezolutës së Kuvendit, ne kemi pranuar një informatë prej Byrosë Kosovare të Sigurimeve, sipas të cilës aktuarët kanë konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për ti ulur çmimet e polisave kufitare, për çfarë ne nuk jemi pajtuar dhe kemi kërkuar të bëhet një vlerësim aktorial nga një aktuar i pavarur.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2017.
2. Kryesia e Kuvendit, në bazë të nenit 29, të Ligjit nr. 03/L-209, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ftojë guvernatorin e BQK-së, për paraqitjen në Kuvend, të Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2017, me rastin e shqyrtimit të këtij raporti në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku